



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 18.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkeses për ri-shqyrtim të datës **30.04.2025** të parashtruar nga **oe ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik **ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1 kundër Njoftimit për Kontratë të datës 03.04.2025 të publikuar në platformën elektronike.
- II. **Korrigjohet**, Njoftimi për Kontratë i datës 03.04.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, do të procedoj me Formularin për korrigjim B54;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.**, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimin e Objektivit të Spitalit të përgjithshëm në Ferizaj - vazhdim projekti”** me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues

Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes sipas nenit 51 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, paragrafi 3.

Pretendimi ankimore te OE ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.,

DUKE iu referuar datës së fundit për dorëzim të tenderëve që është data 08.05.2025 i sipas “B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara”

DUKE iu referuar kërkesave ligjore, gjegjësisht Neni 108/A [Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve], paragrafi 3.1 *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Paraqesim brenda afatit këtë kërkesë për ri-shqyrtim, mbi bazën e asaj që kërkesat e parashtruara nga autoriteti kontraktues janë në kundërshtim me ligjin dhe Rregulloren për Prokurim Publik, dhe atë;

I. Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes sipas nenit 51 nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, paragrafi 3.

Autoriteti kontraktues gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ka përshkruar kërkesat e përzgjedhjes që nuk janë proporcionale dhe relevante me natyrën e aktivitetit të prokurimit sipas kërkesave të këtij paragrafi, sepse për kërkesat e mëposhtme;

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, nenin 9.1&9.2

Kërkesa 1. *Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme ndërtim ose renovim, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 30 Milion Euro, të përfunduara gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Në kuadër të projekteve të kësaj realizuar të paktën një kontratë me vlerë së paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit).*

Nuk pranohen objektet individuale, projekte infrastrukturore, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim, e të ngjashme. Në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Dëshmia 1. *Një Listë të projekteve të realizuara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet të ketë këto të dhëna – Titullin kontratës, - Investitori, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Për çdo projekt të realizuar kërkohen referencat apo pranimet teknike (të përkohshme ose finale). Për investitor privat kërkohet edhe Paramasa e punëve të kryera, certifikata e pranimet nga komuna ose certifikata të pranimet teknik të lëshuara nga kompani të licencuara-të autorizuar për këtë qëllim në vendin ku ndërtimi është realizuar. Për OE pretendues për kontratë AK do të verifikoj transaksionet bankare të projekteve private.*

Kërkesa 2. *Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë që mund të përdori për këtë projekt ose mbështetje bankare për realizimin e këtij projekti financiar të aprovuar në emër të projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro. Në rast të grupit të OE, së paku 51% të plotësohet nga lideri i grupit.*

Për OE pretendent për kontratë, para shpalljes si fitues, AK do të vërtetojë dëshmitë e ofruara të gjendjes financiare, a të disponon mjetet e gatshme në bankë ose mbështetjen bankare.

Dëshmia 2. *Letër konfirmimi nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në llogarinë e tij bankare që mund të përdori për këtë projekt ose limit financiar të aprovuar në emër të projektit, në vlerën e përgjithshme prej së paku tetë (8) milion Euro.*

Ne rast te grupit te OE, lideri i grupit duhet ta plotësoj se paku 51% te vlerës se kërkuar. Dokumenti të jetë original i nënshkruar dhe vulosur.

KONSIDEROJME se janë kufizuese dhe kanë tendencë të keq aplikimit të kërkesave ligjore sepse:

“**Kërkesa 1**” e mësipërme dhe nivelet e shumave të aplikuara janë jashtë çdo proporcioni normal të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimi, sepse siç shihet në tabelën mëposhtme e marr nga “Përshkrimi i çmimit/Paramasa dhe Llogaria”, ajo që mund të konsiderohet “**specifike**” si natyrë e këtij aktiviteti është vetëm pjesa “**GM-Instalimet Gazi Medicional**”, sepse pjesa tjetër janë punë të zakonshme ndërtimore ku të gjitha kompanive ndërtimore mund t’i realizojnë, vetëm nëse siguruar më parë furnizimet/materialet e kërkuara, pasi që është sfidë tjetër.

RIKAPITULLIMI	
AS	ARKITEKTURA DHE STRUKTURA
M	INSTALIMET MAKINERIKE
GM	INSTALIMET GAZI MEDICIONAL
G	INSTALIMET E ASHENSORVE
H	INSTALIMET HIDROSANITARE
H	INSTALIMET ELEKTRIKE

Andaj, në kuadër të këtyre punëve specifike (GM-Instalimet Gazi Medicional) mbase mund të kufizohej kërkesa e autoriteti kontraktues deri në një mase të arsyeshme dhe minimale si kërkesë ndaj “**LIDERIT**” të grupit, në përputhje me nenin 26.10 të Rregullores, p.sh një vlerë e përafërt e llogaritur do ishte 1 milion euro me pjesëmarrjen në objektet spitalore por jo në këtë nivel, prej 8 (tetë) milion euro te një objekti shëndetësor, kur vetëm ky pozicion bën ndryshimin nga ndërtimet tjera të objekteve.

*“26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një **përqindje minimale** në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.”*

Madje, shembulli i marr nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në faqe 33 të ‘Udhëzues nr. 002/2024, për plotësim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik’ i referohet qarkullimit financiar, dhe jo referencave te veçanta.

Po ashtu, kërkesa e juaj ka dy KUFIZIME dhe njëkohësisht DY KUPTIME të cilat do vënë në LAJTHITJE pjesëmarrësit e mundshëm, sepse; kufizimi i **parë** prej së paku 8 milion i referohet një objekti ndërtimor spitalor (ndërtim dhe /ose renovim, renovim!!!?), ndërsa, kufizimi i **dytë** i referohet nivelit prej së paku 51% e punëve të përfunduara që kërkohet për liderin e grupit.

Tani në kuptim të kërkesës të nivelit prej së paku 8 milionëshit të kërkuar nga lideri, si dhe në kuptim të 51% e punëve të jenë përfunduar po nga liderin, sipas kuptimit të palëve i bie > 4.08 milion euro punë në ndërtimin e një objekti spitalor do plotësonin kërkesën, si së paku >15.3 milion për nivelin tjetër të kërkesës së përgjithshme prej >30 milion.

“**Kërkesa 2**” që i referohet “Kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare”, konsiderojmë së ka një praktikë të qëllimshme dhe të dëmshme për operatorët ekonomik, kur kërkohet që kjo mbështetje të jetë e “**APROVUAR**”, sepse tashmë autoritetet kontraktuese kanë shembull të kësaj kërkesë të propozuar si shembull nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, e cila shpreh vetëm zotimin për të përkrahur operatorët ekonomik nëse kërkojnë diçka të tillë, por jo të

aprovohet, sepse nëse aprovohet quhet kredi, e për çka operatorët ekonomik do duhet të fillonin të paguanin kështu nëse projekti për çdo arsye mund të vonohet apo edhe mos realizohet fare.

Andaj, zotimi për përkrahje/mbështetje nga banka do ishte i mjaftueshëm. Shih shembullin e propozuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në faqe 29 të 'Udhëzues nr. 002/2024, për plotësim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, citati:

“Shembull:

***Kërkesa 1.** Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000 euro qasje për kredi në dispozicion.*

***Dëshmia dokumentare 1.** Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 500.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej 500.000 EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.”*

Prandaj, duke u nisur nga provat dhe argumentet e shtjelluara më sipër propozojmë që autoriteti kontraktues të marrë në konsideratë dhe respektojë kërkesat ligjore të ligjit për prokurim publik, dhe të nxjerrë:

VENDIM

- Të konsideroj SI TË BAZUAR këtë kërkesë për rishqyrtim.
- Të korrigjoj dhe përmirësoj kërkesat e përzgjedhjes në dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të amandamentuara me “B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara

Dëmet materiale

Nuk mund të përcaktohet në këtë fazë, por duhet të kihet parasysh se për të plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit operatorët ekonomik

Pergjigjia e AK në lidhje me pretendimet ankimore të ankuarës

Fillimisht kërkojmë mirëkuptimin tuaj për këtë vendim në kthimin e përgjigjes, kemi menduar se të gjitha kërkesat për rishqyrtim janë trajtuar dhe tani e kemi vërejtur që juve nuk u kemi kthyer përgjigje, ka ndodhur kjo ngatërse nga ana jone e pa qëllimshme, por për shkak të kërkesave të shumta për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP.

Pranohet Pretendimi 1:

Konsiderojmë se kërkesa juaj është plotësuar nga ana jone, me korrigjimin e bërë të datës 15.07.2025 ku është hequr kërkesa: ***Në kuadër të projekteve të kësaj realizuar të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim të një objekti shëndetësor (kërkohet për liderin në rast të grupit).***

Gjithashtu është zbutur edhe kërkesa fillestare **“Nuk pranohen objektet individuale, projekte infrastrukturore, rrugë, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim, e të ngjashme”** dhe me korrigjimin e datës 15.07.2025 **Pranohen dhe objektet banesore kolektive, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe të ngjashme.**

Pranohet Pretendimi 2

Korrigjohet kërkesa nr. 2, te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, dhe kjo kërkesë do te jete ne formën e hartuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në faqe 29 të 'Udhëzues nr. 002/2024, për plotësim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, si ne vijim:


Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën tetë (8) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën tetë (8) milion Euro qasje për kredi në dispozicion.

Dëshmia dokumentare 1. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e tetë (8) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej tetë (8) milion EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te këtij vendimi.**


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit